



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 1803/11 Prot.

Tiranë, më 01.10 2018

DEKLARATË MJEDISORE
për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Në mbështetje të nenit nr. 12 të ligjit nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor" dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, ministri lëshon këtë Deklaratë Mjedisore për:

**PLANIN BASHKIAK TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA PËR
BASHKINË RROGOZHINË**

Kufijtë e zonës që mbulon plani: sipërfaqja në administrimin e bashkisë Rrogozhinë, njësitë e saj administrative. Sipërfaqja e përgjithshme që mbulon plani është ajo e Bashkisë Rrogozhinë, që është 229.76 km² e ndarë në pesë Njësi Administrative.

Përdorimi i deklaratës mjedisore:

Deklarata Mjedisore nuk përjashton detyrimin, që për projekte të veçanta të parashikuara në këtë Plan, t'i nënshtrohen kërkesave të legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, për lejet e mjedisit dhe akteve të tjera normative në fuqi.

Qëndrimi i ministrisë lidhur me propozimin:

Duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutese, plani në tërësi, si dhe të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.

Përputhja e planit të propozuar me objektivat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe legjislacionin mjedisor:

Vlerësohet se Plani është hartuar në përputhje të plotë me parimet themelore të hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve, të përcaktuara edhe nga Strategjia dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve në Shqipëri.

Plani i propozuar në parim përputhet me objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe plotëson kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi.

Në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore, vërehet një përputhshmëri e pjesshme e parë në kontekstin e përgjithshëm, ku sipas fushave përkatëse mjedisore, intensitetin më të madh të ndikimeve në mjedis e marrin ndërhyrjet e forta në terren, siç janë ato të zhvillimit të infrastrukturës për asgjësimin e mbetjeve, por plani bashkiak i menaxhimit të mbetjeve të ngurta për bashkinë Rrogozhinë mund të zbatohet plotësisht në terren dhe të jetë miqësor me mjedisin vetëm duke respektuar standardet,

kushtet dhe masat specifike mjedisore që do të rrjedhin nga vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM) specifik i secilit projekt.

Arsyetimi se si janë marrë në konsideratë mendimet e publikut për pasojat në mjedis të planit:
Në takimet e organizuara me publikun dhe palët e përfshira në procesin e VSM-së ka rezultuar se ky plan është pritur me pozitivitet nga komuniteti i bashkisë Rrogozhinë, pasi ky plan hedh bazat për menaxhimin korrekt të mbetjeve në këtë bashki. Përfshirja efektive e grupeve përkatëse të interesit ka kontribuar në cilësinë e vlerësimit, ka sjellë të dhëna për analizën dhe raportin e VSM-së dhe do të mbështesë zbatimin e planit pas miratimit të tij, si dhe do të kontribuojë në një pranim më të lehtë dhe më të zbutur të projekteve përkatës.

Ndikimet e mundshme në mjedis të planit:

Gjatë zbatimit të projekteve/veprimeve, priten ndikime pozitive dhe negative. Ndikimet pozitive priten për përmirësimin e cilësisë së ajrit, kryesisht nga mirë menaxhimi i mbetjeve dhe ndryshimet klimatike, si edhe për popullatën dhe asetet materiale. Vlerësimi i rezultateve tregon se do të ketë ndikime pozitive mbi faktorët klimatikë, duke konsideruar që mjetet e transportit, grumbullimit dhe metodat e menaxhimit të mbetjeve do të vijnë të rinovohen në të ardhmen edhe më tej, gjë që do të sjellë si pasojë përmirësim të cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit human, midis të tjerave për më tej në pjesën pozitive të impakteve mbi popullatën dhe asetet materiale do të vijë si rezultat i zbatimit të infrastrukturës për menaxhimin e mbetjeve në përgjithësi për këtë bashki.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës për menaxhimin e mbetjeve në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi zona ka veçori të theksuara diverse dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukturës, sidomos atyre me shtrirje të gjerë dhe korridoreve sipas sektorëve (transport, energji, ujë, etj.). Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgiminë kulturore dhe peisazhin. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave. Ndikime negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe ndikimet në cilësinë e ajrit gjatë procesit të pozicionimit të infrastrukturës për menaxhimin e mbetjeve në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme, veçanërisht në zonat me densitet të lartë banimi ku do të përqëndrohen edhe një sërë veprimesh në territor të ngushtë dhe kjo do të ndikojë kryesisht në fazën e zbatimit të projekteve specifike.

Masat zbutëse që duhet të merren për mbrojtjen e mjedisit:

Me qëllimin për të shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis të planit në të gjithë fazat e tij duhet të zbatohen me përpikmëri të gjitha masat e mëposhtme.

- Politikat dhe aktivitetet infrastrukturore të parashikuara në Plan të sigurojnë kohezion, efikasitet dhe qëndrueshmëri dhe rritjen e përfitimeve për përdoruesit e kësaj infrastrukture.
- Të mbrohen vlerat natyrore të zonave në të cilat shtrihet studimi dhe të shmangen në maksimum dëmtimi i sipërfaqeve me vegjetacion natyral.
- Projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me kuadrin ligjor për mbrojtjen e natyrës, duke respektuar shkallën e mbrojtjes së zonës apo nënzonës së mbrojtur ku do të ndërhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve që gjenden në zonë, si dhe të

komunikohet/bashkëpunohet me AKZM-në për të marrë masat e domosdoshme për mos cënimin e statusit të këtyre zonave.

- Gjatë fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të projekteve/aktiviteteve specifike individuale të Planit duhet të përfshihen masa që do të lehtësojnë ruajtjen e korridoreve të kafshëve migratore. Në rastin kur projektet që do zbatohen mund të prekin zona të Mbrojtura apo mund të ndodhen në afërsi të tyre.
- Të zbatohen masa zbutëse për zhvillimin e infrastrukturës, gjatë rehabilitimit/ndërtimit duhet të parashikojnë edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar “best practices“. Në asnjë rast nuk duhet të projektohet brenda, por as në afërsi të territorit të zonave të mbrojtura, kur impaktet nga shkarkimet në ajër dhe zhurmat ndikojnë ekosistemet dhe habitatet e llojeve nën mbrojtje.
- Të merren masa për mbrojtjen dhe mos dëmtimin e burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore që gjenden në zonën në studim.
- Në kuadër të planifikimit të menaxhimit, vëmendje e veçantë të kushtohet për integrimin e zonave të sigurisë nga përmbytjet dhe atyre ligatinore, ndërkohë që masat e pyllëzimit të synojnë stabilizimin e humbjeve e tokës nga përmbytjet (të zbatohet duke përdorur lloje të bimësisë autoktone që i rezistojnë edhe përmbytjeve).
- Të zbatohen kërkesat në afatet e përcaktuara kohore të legjislacionit të mbetjeve në fuqi, si dhe të bashkëpunojnë në kuadër të rrjetit të integruar të instalimeve, në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, për të bërë të mundur grumbullimin maksimal të diferencuar të mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin ose depozitimin në një prej instalimeve më të afërta, të përshtatshme me metodat dhe teknologjitë e nevojshme, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë mjedisor dhe të mbrojtjes së shëndetit publik.
- Para fillimit të zbatimit të projekteve, të zgjidhet çështja e administrimit të volumit inert që do të gjenerohet nga operacionet ndërtimore.
- Në tërësi, projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me standartet e ruajtjes së peisazhit dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ku së bashku me elementet e cilësive së mjedisit të jenë parësore duke aplikuar “best practices“.
- Gjatë implementimit të planit të vihen në zbatim masa zbutëse e propozuara në raportin e VSM-së për minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis.
- Pavarësisht masave dhe rekomandimeve të kësaj Deklarate Mjedisore, gjatë zbatimit të planit është e detyrueshme të zbatohen kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi;
- Shfaqja e elementeve të rinj ekologjike të panjohur, në kohën që kjo Deklaratë Mjedisore është dhënë, sjell si detyrim rivlerësimin e saj.
- Nëse plani nuk është miratuar brënda 2 viteve nga data e miratimit të deklaratës, atëherë deklarata bëhet e pavlefshme dhe procedura e VSM-së fillon nga e para.
- Në rast se ministria, strukturat e saj të varësisë, njësitë e qeverisjes vendore, apo edhe grupet e interesuara, përfshi edhe publikun, konstatojnë se plani nuk zbatohet në përputhje me vendimin për miratimin e tyre dhe nuk respektojnë kushtet e kërkesat e përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit, atëherë ministria njofton menjëherë autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e miratimit të planit dhe sipas rrethanave, i kërkon sqarimet përkatëse, apo ndalimin e menjëhershëm të zbatimit të planit, deri në sqarimin e situatës.
- Nëse pasojat në mjedis e shëndet, tejkalojnë standardet mjedisore në fuqi, atëherë ministria i kërkon autoriteteve miratuese e zbatuese të planit të merren masa e duhura për shmangien/minimizimin e ndikimeve negative, ose të vlerësohet edhe ndryshimi i planit, me qëllim që të përmbushen standardet mjedisore.
- Për mos respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Deklaratë Mjedisore dhe të legjislacionit mjedisor në fuqi ka sanksione ligjore dhe nënligjore.

Kërkesat për monitorimin mjedisor raportimin periodik në ministri gjatë zbatimit të planit:

- Të hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjatë zbatimit të planit, me synim mbledhjen e të dhënave për ndikimet konkrete dhe pasojat në mjedis gjatë zbatimit të tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutëse shtesë, që duhet të zbatohen për të garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky plan të hartohet brenda 6 muajve nga marrja e Deklaratës Mjedisore dhe të merret miratimi i autoriteve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit.
- Me qëllim lehtësimin e realizimit të programit të monitorimit mjedisor të planit mund të përdoren programe ekzistuese monitorimi, që përputhen me qëllimin e programit të monitorimit mjedisor të planit.

Kërkesa për raportim mjedisor periodik

- Bashkia Rrogozhinë, që zbaton dhe mbikqyr zbatimin e planit, duhet të hartojë periodikisht 1 herë në vit, një raport vjetor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit, të cilin duhet ta dërgojë pranë Ministrisë jo më vonë se java e fundit e muajit nëntor.

MINISTËR

Blendi KLOSI